



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembl

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 07
Prishtinë, më 28.03.2012, në orën 11.00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në këtë mbledhje morën pjesë: Suzan Novoberdali – kryetare, Rita Hajzeraj, Kurtan Kajtazi, Albana Gashi, Biserka Kostiq, Kymete Bajraktari dhe Kimete Bytyçi.

Munguan: Justina Pula dhe Duda Balje.

Pjesëmarrës të tjerë: Elita Vokshi dhe Lejla Selimi-OSBE, Ibush Sylejmani-Shoqata e të Verbërve të Kosovës, Ujup Rashica dhe Mirsad Mulla-SHNV, Prishtinë, Visar Bivolaku-EU OFFICE, Xhemajl Ahmeti- OHCHR, Ukë Gashi- ZPRK, Mehrije Nikqi, Daut Tishuku, Antigona Beha, Bujar Kadriu, Mexhit Foniqi dhe Ilirjana Hamzaj- Shvpdk, Nuredin Ibishi-CDF dhe Burim Tahiri- praktikant.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj - koordinator dhe Sulltane Gashi - zyrtare ligjore.

Mbledhjen e kryesoi, Suzan Novoberdali- kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi procesverbalit të mbledhjes së mbajtura më 21 mars 2012;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i amendamenteve të dhëna në projektligjin për persona të

- verbër dhe personat pjesërisht të verbër;
4. Shqyrtimi i kërkesës se Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje për debat Parlamentar, lidhur me marrëveshjen për përfaqësim rajonal të Republikës së Kosovës;
 5. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi procesverbalit të mbledhjes së mbajtura më 21 mars 2012.

Komisioni miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së mbajtura më 21 mars 2012.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i amendamenteve të dhëna në Projektligjin për persona të verbër dhe personat pjesërisht të verbër

Kryetarja- Tha se sa i përket këtij projektligji, me lejoni që ta prezantoj në pika të shkurtra rreth amendamentimit të këtij projektligji, Grupi punës ka bërë disa ndryshime dhe ka bashkëpunuar me përfaqësuesit e Shoqatës për Persona të Verbër, të cilët i dinë më së miri nevojat e tyre.

Ne kemi pasur propozime të ndryshme, sidomos sa i përket nenit 7, lidhur me heqjen e kategorisë së personave pjesërisht të verbër dhe se numri i përfituesve nga ky ligj është zvogëluar, prandaj ligji është me i zbatueshëm në praktikë, dhe për këtë neve na duhet të arrijmë në një koncesus dhe lidhur me këtë kemi propozimin tim dhe të deputetes Albana Gashit. Ajo Komisionit ia paraqiti amendamentin e vetë si vijon:

„Personat e verbër për shkak të verbërisë marrin nga buxheti shtetëror pension në lartësi prej 50% të pagës mesatare”.

Arsyetimin e mbështeti në atë se është pajtuar Shoqata e të Verbërve të Kosovës dhe do të ishte më e përballueshme për buxhetin e Kosovës.

Mirëpo, kemi propozimin e deputetes Albana Gashi, e cila mendon se 50% janë të ardhura të vogla për nevojat e këtyre personave dhe ajo ka propozimin për 70% të pagës mesatare. Deputetja do ta arsyetojë vetë propozimin. Ajo e ftoi deputeten që ta arsyetojë amendamentin.

Albana Gashi- Duke pasur parasysh kategorizimin që është bërë, kategoria e tretë e të verbërve është hequr nga ky ligj dhe kanë mbetur dy kategori. Nga ana tjetër përfiton shoqëruesi, vetëm kategoria e parë e të verbërve. Mendoj se është një numër i vogël i përfituesve dhe e kemi parë të arsyeshme që përfitimi të jetë 70% i pagës mesatare, pasi që Qeveria e ka për obligim të ofrojë jetë më të mirë për qytetarët e saj. Unë ju kisha lutur të votoni këtë propozim timin që të ardhurat të jenë 70% të pagës mesatare.

Kurtan Kajtazi- Duke u ndërlidhur me propozimet e dhëna tha se dihen mundësitë buxhetore dhe marrëveshjet me Fondin Monetar, të gjithë kemi dëshirë që të ardhurat e

këtyre personave të jenë sa më të mëdha, ka qenë një propozim i Qeverisë në projektligj që qeveria përcakton paga për këta dhe askush nuk e di se sa janë në numër të anëtarësuar persona të verbër. Shoqata ka një numër, por ka shume persona të tjerë që nuk janë të anëtarësua në Shoqatën e të Verbërve të Kosovës. Ne e dimë se Ministria e Financave ka kërkuar ta shtyjë projektligjin, sepse ka implikime të mëdha buxhetore, por jemi ulur me ministrin dhe zv.ministrin dhe kemi biseduar. Prandaj nuk duhet të flitet me emocione, sepse nuk kalon ligji. Unë jam që të mbetet propozimi si është në projektligj.

Rita Hajzeraj- Tha se është një projektligj i cili nuk do t'i zgjedhë të gjitha hallet e kësaj kategorie. Propozimi i parë ka qenë 70% i pagës minimale. Ne është mirë, si Komisioni, të biem dakord për një mes të këtyre propozimeve, dhe unë mendoj që të jetë 60% e pagës mesatare për këtë kategori të personave.

Kryetarja- Tha se sa i përket propozimit të Qeverisë tani ai propozim nuk vlen më sepse ai është paraparë kur me ligje janë përcaktuar edhe disa benificione të tjera për këtë kategori. Tani ata nuk gëzojnë më benificione të tjera. Ne po shkojmë nga ajo se ndoshta mendojmë t'i bëjmë mirë kësaj kategorie, e jo keq! Prandaj duhet të shkohet nga ajo që të jemi sa më real dhe kërkesa të jetë e zbatueshme.

Rita Hajzeraj- Tha se të gjitha vendet e rajonit për këtë kategori kanë caktuar që të ardhurat e tyre të jenë 60% te pagës mesatare.

Kurtan Kajtazi- Mendimi im është që të kalohet me versionin e Qeverisë, nëse mendohet të shkohet me një propozim tjetër, duhet të analizohet nga ekspertët, me ministrin dhe Komisionin për Buxhet dhe Financa që të shqyrtohet, a ka mundësi të bëhet kështu të mos e çojmë një propozim, i cili nuk ka mundësi të përballohet nga buxheti, sepse ka mundësi të mos zbatohet.

Kryetarja- Meqë kemi tri propozime të ndryshme do i qesim në votim dhe shohim se cili nga propozimet do të kaloj.

Albana Gashi- Meqë kemi këto propozime unë e tërheq propozimin tim dhe votoj për variantin me 60%, përndryshe votoj kundër këtij projektligji.

Komisioni pas një debati të gjatë dhe konstruktiv e hodhi në votim propozimin e grupit punues dhe rezultati ishte si vijon:

Komisioni me 4 për dhe 3 kundër, votoj për këtë propozimin „Personat e verbër për shkak të verbërisë marrin nga buxheti shtetëror pension në lartësi prej 60% të pagës mesatare.”

Komisioni nuk e mbështeti propozim -amendamentin e deputetes Suzan Novoberdaliu dhe vendosi pa përkrahje të Komisionit t'ia procedojë Kuvendit si vijon:

„Personat e verbër për shkak të verbërisë marrin nga buxheti shtetëror pension në lartësi prej 50% të pagës mesatare.

Komisioni në tërësi e votoi projektligjin dhe lidhur me këtë nxori këtë

Përfundim

Komisioni unanimisht votoi amendamentet e propozuara në Projektligjin për personat e verbër dhe pjesërisht të verbër dhe raporti me amendamente duhet të procedohet në komisionet kryesore për shqyrtim.

4. Shqyrtimi i kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje për debat Parlamentar, lidhur me marrëveshjen për përfaqësim rajonal të Republikës së Kosovës

Kryetarja- Tha se ne për shqyrtimin e kërkesave dhe peticioneve kemi grupin punues i cili bën shqyrtimin dhe na paraqesin mendimet e tyre në komision. Ne, si Komision, vendosim se çka do të ndërmarrim lidhur me to.

Kurtan Kajtazi- Tha se kemi shqyrtuar këtë peticion që e kemi para vetes. Unë po i referohem nenit 65 të kushtetutës së Republikës së Kosovës, ku thuhet se Kuvendi vendos për çështjet me interes të përcaktuara me ligj. Me këtë nen vendos Kuvendi nëse procedohet me mocion procedural të rregullt me Rregulloren e punës së Kuvendit. Unë mendoj se ky peticion është thirrur në nene të gabuara, sepse me 6 nënshkrime të deputeteve mund të bëhet debat parlamentar me vendim të Kryesisë së Kuvendit. Kryesia e Kuvendit mund të vendosë që ta qesë në rend dite një çështje, e cila i ka respektuar procedurat e parapara me rregullore të Kuvendit. Ne duhet të vendosim kështu: Nënshkrimet e mbledhura për këtë çështje nuk janë në harmoni me kushtetutën dhe Rregulloren e punës së Kuvendit pasi që seancë mund të thërrasë vetëm autoriteti i përcaktuar me Kushtetutë, siç është paraparë më lartë. Për çështje të debatit subjekti i interesuar mund të thërrasë seancë në harmoni me rregulloren e punës së Kuvendit duke respektuar procedurat e saj në bazë të nenit 15 të Rregullores së Kuvendit.

Rita Hajzeraj- Duke u ndërlidhur me këtë peticion tha se këto që u thanë janë të bazuara në Kushtetutë dhe rregullore. Subjekti politik, që e ka bërë peticionin, është pjesë e Parlamentit të Kosovës, dhe duhet të kihet kujdes që të mos shkelet asnjë nen i Kushtetutës dhe rregullores.

Kurtan Kajtazi- Nënshkrimet e mbledhura për këtë çështje nuk janë në harmoni me Kushtetutën dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit. Ne duhet ta informojmë Kryesinë e Kuvendit se për çështje të debatit parlamentar, subjekti politik i Vetëvendosjes mund të thërrasë seancë në harmoni me Rregulloren e punës së Kuvendit duke respektuar procedurat.

Albana Gashi- Tha se kjo kërkesë është bërë duke u bazuar në nënshkrimet e qytetarëve dhe pa marrë parasysh se a e ka organizuar një subjekt politik, ose kush e ka organizuar

janë përmbi trembëdhjetë mijë nënshkrime që e kanë dashur një seancë të jashtëzakonshme.

Kryetarja – Tha se seancën e jashtëzakonshme parlamentare, sipas kushtetutës kanë të drejtë ta thirrin dyzet deputetë me nënshkrimet e tyre, Presidentja dhe Kryeministri. Kjo kërkesë sipas meje është e paqartë dhe duhet të jetë e qartë, të sqarohet për t' u shqyrtuar në Komision. Unë mendoj kjo kërkesë të hidhet sepse nuk është e qartë.

Komisioni pas një debati të gjerë vendosi ta nxjerrë këtë:

Përfundim

Kjo kërkesë nuk bie në fushëveprimtarinë tonë duke u bazuar në rregullore dhe Kushtetutë, sepse kërkesa dhe bazueshmëria nuk janë në harmoni ne mes vete, dhe se subjekti e ka këtë mundësi me 6 deputetë të thërrasë debat parlamentar.

5. Të ndryshme.

Për këtë pikë të rendit të ditës nuk pat ndonjë çështje për diskutim.

Mbledhja përfundoi në orën 12:20.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Suzan Novoberdali